



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 125 Akti

Nr. 183 Vendimi
Tiranë, më 19.7.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Lulzim Hamitaj	Anëtar
Suela Zhegu	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në Tiranë, në datën 16 korrik 2019, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Petrit *** Çano**, me funksion prokuror/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, i cili pranoi rezultatet e hetimit dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç, dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit *** Çano, me funksion prokuror/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.3.2018, në përputhje me Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 17.5.2018, u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues komisioner Olsi Komici. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Theo Jacobs.

Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK); dhe Prokuroria e Përgjithshme (në vijim PP).

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI) në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të

¹ Raporti nga ILDKPKI-ja i dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 22.1.2018.

arsyetuar², duke konkluduar mbi “Përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, Petrit Çano”.

Prokuroria e Përgjithshme (PP) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.

Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 17.5.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Petrit Çano, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t’u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52, të ligjit 84/2016, si dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Për një proces të rregullt ligjor, z. Petrit Çano, i janë garantuar të drejtat, si: për t’u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; përbërjen e trupit gjykues; si dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Për sa rezultoi nga hetimi administrativ i procesit të rivlerësimit iu dha 7 ditë kohë për t’u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

Z. Petrit Çano, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e tij në datën 23.5.2019. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 5.6.2019. Trupi gjykues u mbledh pas seancës dëgjimore, dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi, me shumicë votash, vendosi rihapjen e hetimit për kryerjen e disa verifikimeve dhe kërkime shtesë për marrjen e provave të reja. Pas mbylljes së hetimit administrativ shtese në datën 10.7.2019 subjekti u njoh me hetimin shtesë dhe u ftua serish në seancë dëgjimore.

Seanca dëgjimore u zhvilluan në datat 16.7.2019 dhe 19.7.2019, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

² Me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2017, dërgohet raporti i DSIK-së, deklasifikuar me vendimin KDZH nr. ***, datë 27.9.2018.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.2018, dërgohet raporti i Grupit të Punës në Prokurorinë e Përgjithshme.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çano, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, z. Petrit Çano, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

Ndërsa, sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Referuar vendimit Nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga Prokuroria e Përgjithshme;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;

h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Z. Petrit *** Çano, me funksion prokuror/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, përfshin të tria kriteret: të vlerësimit të pasurisë; të kontrollit të figurës; dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çano, është bërë subjekt deklarues në vitin 2003 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private nga viti 2003 - 2016 si dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar për efekt të ligjit nr. 84/2016 (siç quhet ndryshe dhe deklarata “Vetting”).

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, mundësisë për fshehje të pasurisë, deklarim të rremë apo konfliktin e interesit.

HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Në deklaratën e pasurisë sipas formularit (shtojca 2) të datës 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çano, dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar këto pasuri:

1. Apartament⁴ me sip. 102.6m², i ndodhur në Rr. “****” (ndryshuar në Rr. “****”), sh. ***, ap. ***. Vlera: 7.500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Pasuri e blerë në datën 9.11.2011.

Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit për këtë pasuri.

Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore të paraqitura në ILDKPKI rezulton se në deklaratën vjetore për vitin 2011, subjekti ka deklaruar si burim krijimi: Blerë shtetasit Q.B., me paratë e dhëna hua, të deklaruara më parë 7 milionë lekë, si dhe shumën prej 500.000 lekësh paguar po këtë vit. Në deklaratimet periodike vjetore të pasurisë, subjekti ka deklaruar shumat e dhëna hua këtij shtetasi, për efekt të blerjes së pasurisë apartament.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ZVRPP-ja Tiranë ka konfirmuar se pasuria apartament, me sipërfaqe 102.6 m², me nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, është regjistruar në emrin e subjektit dhe bashkëshortes, në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

OSHEE-ja ka informuar se në emër të z. Petrit Çano identifikohet kontrata ***, në adresën: “****”, shk. ***, ap. ***, Tiranë, me status aktiv, me datë hapje 15.9.2007.

⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

➤ Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, për pasurinë nr. ***, z.k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit apartament me sip. 102.6 m². Bashkëlidhur kartelë pasurie, vlera e paguar 7.500.000 lekë, data e regjistrimit 28.12.2011. Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme (apartament) me nr. ***, datë 9.12.2011. Vlera e pasurisë 7.500.000 lekë. Palë shitëse Q., dhe A.B., dhe palë blerëse Petrit Çano. Bashkëlidhur praktika e përfitimt të apartamentit nga pala shitëse.

UKT-ja konfirmoi se subjekti i rivlerësimit është abonent me kontratë me nr. ***, me adresë: Rr. “***”, me status aktiv, detyrime të likuiduara deri në gusht 2018.

➤ **Komisioni në lidhje me mosdeklarimin e burimit të krijimit, në deklaratën “Vetting”, i ka kërkuar shpjegime subjektit.**

Subjekti⁵ ka shpjeguar se mospërmendja e burimit të të ardhurave të kësaj pasurie ka qenë thjesht një pasaktësi e tij në plotësimin e formularit duke menduar se ka qenë i mjaftueshëm fakti që kjo e dhënë është bërë prezentë në deklarimin periodik për vitin 2011...”. Ai deklaroi se burimi i të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie ka qenë nga:

- i. shitja e apartamentit të banimit në pronësinë e tij në Fier, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 4.5.2006, në vlerën 5.500.000 lekë;
- ii. kursimet e krijuara ndër vite nga paga dhe shpërblimet e tij; si dhe
- iii. nga pagat dhe aktiviteti i bashkëshortes.

Subjekti ka vënë në dispozicion kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 4.5.2006, me palë shitëse P., dhe M.Ç., dhe palë blerëse Sh.B., me objekt shitblerjen e një apartamenti banimi, të ndodhur në z.k. ***, lagjja “***”, Fier, me sip. 66 m², në shumën prej 5.500.000 lekësh.

Nga hetimi ka rezultuar se me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 4.5.2006, z. Petrit Çano, i shtetasi Sh.B., apartamentin e banimit me sip. 66 m², në shumën **5.500.000** lekë, shumë e likuiduar në prezencë të noterit në zyrën noteriale.

Subjekti ka deklaruar se këtij apartamenti i bashkëngjitej dhe një shtesë ndërtimi me sip. 36 m² (si shtesë anësore për çdo kat të këtij pallati). Në kontratën përkatëse të shitblerjes nuk është përfshirë shtesa, pasi ishte e paregjistruar në ZVRPP-në Fier.

➤ **Komisioni i kërkoj subjektit informacion dhe dokumentacion në lidhje me shtesën anësore me sip. 36 m², të kryer pa leje ndërtimi.**

Subjekti depozitoi⁶ në Komision dokumentacionin e dosjes së aplikimit për legalizimin e kësaj shtese të kryer nga shtetasi Sh.B., (blerësi i këtij apartamenti). Nga aktet e dosjes së legalizimit ka rezultuar se z. Sh.B., në datën 11.9.2006, ka bërë vetëdeklarimin për legalizim të shtesës anësore me sip. 36 m², në emër edhe të banorëve të tjerë (N.Z., Dh.K., dhe S.P.).

Sipas certifikatës për vërtetimin e pronësisë së lëshuar nga ZVRPP-ja Fier, shtetasi Sh. B., e ka regjistruar apartamentin në pronësi të tij në datën 9.6.2006.

Komisioni ka kërkuar informacion⁷ nëse subjekti apo banorët e pallatit kanë aplikuar për t’u pajisur me leje ndërtimi pranë autoriteteve përkatëse përpara se të ndërtohej shtesa në pallat, si dhe të depozitonte dokumentacion për aplikimin.

Subjekti⁸ ka shpjeguar : “Për ndërtimin e shtesës ishin të interesuar të gjithë banoret e shkallës ku banonte. Për këtë shkak bashkërisht në datën 28.6.2000 përpara noterit kanë bërë një deklaratë në të cilën shprehet vullneti i banorëve për të ndërtuar një shtesë në anën veriore ngjitur me faqen e murit ekzistues dhe në përputhje me rregullat e Urbanistikës. Siç thuhet edhe në deklaratë me sa subjekti ishte në dijeni, është bërë kërkesë për leje në Bashkinë e qytetit të Fierit. Subjekti deklaroi se dispononte një kopje të deklaratës të cilën e vuri në dispozicion por nuk ka disponuar kopje të kërkesës së drejtuar Bashkisë, mbasi me këtë procedurë është angazhuar një nga banorët e pallatit, të kateve të poshtëm nga do të fillonte ndërtimi. Subjekti

⁵ Shihni përgjigjet e pyetësorit të 2-të, dërguar nga subjekti në datën 29.10.2018, në dosjen e Komisionit.

⁶ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 4, dërguar nga subjekti në datën 23.12.2018, në dosjen e Komisionit .

⁷ Me pyetësorin e datës 26.3.2019

⁸ Me pyetësorin e datës 26.3.2019

shpjegoi se u interesua pranë Bashkisë së qytetit të Fierit për të siguruar një kopje të kërkesës, por për arsye se personi përgjegjës i zyrës së arkivës ishte me leje të zakonshme nuk iu ofrua ky shërbim”.

Komisioni vëren se subjekti depozitoi një deklaratë noteriale të datës 28.6.2000 ku citohet ndërtimi i një shtese në njërin anë të pallatit. Në fund deklarata është nënshkruar nga banorët: Dh.K., S.P., N.Z., dhe Petrit Çano.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave dhe fakteve

Komisioni, duke analizuar dokumentacionin e dosjes së legalizimit dhe shpjegimet e subjektit në përgjigje të pyetësorëve, argumenton se kjo shtesë anësore pallati me sip. 36 m², ka qenë një kërkesë e banorëve për zgjerim të hapësirës së banimit, në këto rrethana ndërtimi pa leje nuk provohet të jetë kryer personalisht nga subjekti i rivlerësimit dhe referuar ligjit të kohës, në vitin 2000, kur ka nisur ndërtimi i kësaj shtese anësore, ndërtimet pa leje konsideroheshin kundërvajtje administrative, sipas ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, në fuqi në kohën e kryerjes së ndërtimit.

➤ Komisioni i kërkoi subjektit informacion dhe dokumentacion në lidhje me vlerën për ndërtimin e shtesës së apartamentit dhe kohën e kryerjes së këtij investimi.

Komisioni kreu analizën financiare për të analizuar mundësinë financiare të subjektit për investimin e kryer, shtesë anësore në vitet 2000 – 2001 nga subjekti. Në këtë analizë janë marrë në konsideratë shpenzimet për ndërtimin e shtesës sipas preventivit të punimeve të kryera, ku vlera e këtij investimi është në shumën prej 697.070 lekësh. Sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, investimi në shumën prej 450,000 lekë u krye gjatë vitit 2000 dhe në shumën prej 247.070 lekë u krye gjatë vitit 2001.

Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, për periudhën 2000 – 2001, janë marrë në konsideratë të ardhurat e dokumentuara sipas vërtetimeve për pagesat *neto* të lëshuara nga institucionet përkatëse.

Analiza financiare për vitet 2000 dhe 2001

Viti	2000	2001
Të ardhura	714 587	901 299
2. Shpenzime	216 000	216 000
3. Rezultati (1-2)	498 587	685 299
4. Investim në apartament	450 000	247 070
Diferenca (3-4)	48 587	438 229

Komisioni, bazuar në analizën financiare, ka konstatuar se subjekti ka pasur mundësi financiare për të përballuar shpenzimet për ndërtimin e shtesës anësore.

Me kontratën e shitblerjes me nr. ***, datë 9.12.2011, z. Petrit Çano, blen nga shtetasi Q.B., apartamentin me sip. 102.6 m², në vlerën 7.500.000 lekë, shumë për të cilën palët deklarojnë se i është likuiduar totalisht shitësit. Referuar certifikatës për vërtetim pronësie nr. ***, kjo pasuri është regjistruar në emër të z. Petrit *** Çano, në datën 28.12.2011.

- **Komisioni, hetoi lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit**, duke i kërkuar shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k.,⁹ kopje të kontratave të shitblerjes për apartamentet e shitura në pallatin e ndodhur në Rr. “****”.

Shoqëria “****” sh.p.k.¹⁰ ka depozituar katër kontrata shitblerje pasurie, për apartamente në pallatin ku ka blerë dhe subjekti, dhe nga shqyrtimi i këtyre akteve Komisioni vëren se nuk ngrihen dyshime në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit.

- **Komisioni hetoi në lidhje me mënyrën e likuidimit për blerjen e apartamentit.**

Sipas kontratës së shitjes nr.***, datë 9.12.2011, për shitjen e apartamentit, thuhet shprehimisht që çmimi prej 7.500.000 lekësh është likuiduar nga blerësi Petrit Çano.

- ✓ Referuar përgjigjeve të subjektit¹¹ dhe kontratave noteriale vërehet se shumat e përcaktuara në kontratat e huas i janë dhënë shtetasit Q.B., *cash* në dorë përpara noteres.

Këto kontrata noteriale janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore:

- Në deklaratën vjetore për vitin 2006 në rubrikën “të dhëna konfidenciale” deklarohet, dhënë hua shuma 2.000.000 lekë shtetasit Q.B., banues në Rr. “****”, nr. ***, Tiranë, me kontratë huaje nr. ***, datë 29.12.2006, zyra e noteres D.A., Vlorë.
- Në deklaratën vjetore për vitin 2007 në rubrikën “të dhëna konfidenciale” deklarohet dhënë hua shuma 2.000.000 lekë shtetasit Q.B., banues në Rr. “****”, nr. ***, Tiranë, me kontratë huaje nr. ***, datë 19.12.2007, zyra e noteres D.A., Vlorë.
- Në deklaratën vjetore për vitin 2008 në rubrikën “të dhëna konfidenciale” deklarohet, dhënë hua shuma 3.000.000 lekë shtetasit Q.B., banues në Rr. “****”, nr. *** Tiranë me kontratë huaje nr. ***, datë 13.12.2008, zyra e noteres D.A., Vlorë.
- Në deklaratën vjetore për vitin 2011, deklarohen si burim paratë e dhëna hua shtetasit Q.B., të deklaruara më parë, në shumën 7.000.000 lekë, si dhe shuma prej 500.000 lekë, në këtë vit.

Komisioni i kërkoj kopjet e kontratave të huas noterit E.A.¹², i cili na vuri në dispozicion tri kontrata huaje me nr.***, datë 29.12.2006; nr. ***, datë 19.12.2007; dhe nr. ***, datë 13.12.2008.

- Referuar kontratës së huas të vitit 2006, thuhet shprehimisht: “*Huadhënësi Petrit Çano i jep cash në dorë përpara noteres shumën prej 2.000.000 lekësh të reja, pa interes huamarrësit Q.B., për blerjen e një sendi të ardhshëm apartament banimi, në truallin e palës huamarrëse me afat deri në legalizimin e kontratës definitive të shitblerjes së kësaj pasurie*”.

- Sipas kontratës së huas të vitit 2007, thuhet se huadhënësi Petrit Çano i jep *cash* në dorë përpara noteres shumën prej 2.000.000 lekësh të reja, pa interes huamarrësit Q.B., për blerjen e një sendi të ardhshëm apartament banimi në truallin e palës huamarrëse me afat deri në legalizimin e kontratës definitive të shitblerjes së kësaj pasurie.

- Sipas kontratës së huas të vitit 2008 huadhënësi Petrit Çano i jep *cash* në dorë përpara noteres shumën prej 3.000.000 lekësh të reja, pa interes, huamarrësit Q.B., për blerjen e një sendi të ardhshëm, apartament banimi në truallin e palës huamarrëse me afat deri në legalizimin e kontratës definitive të shitblerjes së kësaj pasurie.

⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.3.2019, drejtuar shoqërisë.

¹⁰ Me shkresën nr. ***, datë 28.3.2019,

¹¹ Shihni përgjigjen e pyetjes 1.5 në përgjigjet e pyetësorit të 2-të, dërguar nga subjekti në datën 29.10.2018, në dosjen e Komisionit.

¹² Shihni shkresën kthim përgjigje nr. extra prot., datë 24.10.2018, nga noteri E.A., në dosjen e Komisionit.

Komisioni, duke analizuar kontratat e huas vëren se në thelb këto kontrata përmbajnë elementë të kontratës së porosisë apo sipërmarrjes, të cilat kanë si objekt pagesën me këste dhe blerjen e një sendi të ardhshëm në truallin në pronësi të palës huamarrëse, deri në nënshkrimin e kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie.

Referuar kontratës noteriale të shitblerjes, çmimi i apartamentit është në shumën 7.500.000 lekë.

- ✓ Subjekti i paraqiti Komisionit prova bindëse për pagesat e kryera për blerjen e apartamentit në shumën 7.500.000 lekë.
- **Komisioni analizoi mundësitë financiare të subjektit për pagesat e kryera për blerjen e apartamentit në Tiranë, për vitet 2006, 2007 dhe 2008.**

Përshkrimi	2006	2007	2008
1. PASURI	0	0	0
2. DETYRIME	-2 000 000	-2 000 000	-3 000 000
Hua dhënë shtetasit Q.B.	-2 000 000	-2 000 000	-3 000 000
3. PASURI NETO	2 000 000	2 000 000	3 000 000
4. TË ARDHURA	7 309 899	2 122 518	1 757 593
Të ardhura nga paga subjekti të dokumentuara (përfshirë të ardhurat nga Universiteti *** 2008 – 2013)	1 438 381	1 478 485	1 037 541
Te ardhura subjekti nga Universiteti ***, pagesa në “Union Bank”			91 800
Të ardhura nga paga bashkëshortja të dokumentuara	356 759	414 325	430 629
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Lagjen “*** ” në Fier	5 500 000		
Të ardhura nga interesat e depozitave	14 759	229 708	197 623
5. SHPENZIME	399 182	775 772	679 171
Shpenzime jetese	328 671	522 216	522 216
Shpenzime qiraje shtëpia në Vlorë		100 000	120 000
Shpenzime për udhëtime (TIMS)	70 511	153 556	36 955
6. LIKUIDITETE NË FILLIM TË VITIT	1 490 023	6 511 213	6 095 651
Depozitë bankare subjekti, në “ProCredit Bank”, Fier	1 000 000	11 419	11 419
Llogari në “Credins Bank” në lekë subjekti		5 665 437	5 000 073
Llogari në lekë në “Credins Bank” bashkëshortja	15 998	3 676	26 702

Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” subjekti	319 968	74 023	362 260
Gjendje cash	154 057	756 658	695 197
7. LIKUIDITETE NË FUND TË VITIT	6 511 213	6 095 651	3 756 486
Depozitë bankare në “ProCredit Bank”, në Fier, subjekti	11 419	11 419	10 719
Llogari në “Credins Bank” në lekë, subjekti	5 665 437	5 000 073	3 400 008
Llogari në “Credins Bank” në lekë bashkëshortja (nga 2010 depozita në euro e përbashkët me subjektin)	3 676	26 702	50 005
Llogari depozite me afat në “Union Bank”, subjekti (llogari paga ***)			91 800
Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, subjekti	74 023	362 260	126 482
Gjendje cash (përgjigje të pyetësorit datë 2.11.2018)	756 658	695 197	77 472
DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 4+6-3-5-7)	-110 472	-237 692	417 587

Nga analizimi i të dhënave lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe me shpenzimet për vitet 2006, 2007 dhe 2008, u konstatua:

Për vitin 2006 rezultoi një balancë financiare negative në **shumën - 110.472 lekë**.

Në analizën financiare për vitin 2006 nuk janë marrë në konsideratë fitimet e deklaruara nga aktiviteti privat i bashkëshortes, të deklaruara nga subjekti në shumën e 600.000 lekëve, pasi Komisioni nuk dispononte prova të mjaftueshme mbi të ardhurat e ligjshme të realizuara, nga aktiviteti privat (kopsht fëmijësh) dhe nëse ishin paguar detyrimet tatimore.

Për vitin 2007 rezultoi një balancë financiare negative në **shumën - 237 692 lekë**.

Gjithashtu, në analizën financiare për vitin 2007 nuk janë marrë në konsideratë fitimet e deklaruara nga aktiviteti privat i bashkëshortes, të deklaruara nga subjekti në shumën 800.000 lekë, pasi Komisioni nuk dispononte prova të mjaftueshme mbi të ardhurat e ligjshme të realizuara, nga aktiviteti privat dhe nëse ishte paguar detyrimet tatimor për këto të ardhura.

Për vitin 2008, subjekti ka të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet.

- Në lidhje me konstatimet nga rezultatet e kësaj analize, subjektit iu kërkuan shpjegime.

Në përgjigje të konstatimeve të Komisionit, subjekti paraqiti shpjegime¹³ dhe prova se kishte paguar rregullisht detyrimet tatimore për aktivitetin “kopsht privat” të bashkëshortes. Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Fier¹⁴ u provua se “****” sh.p.k. ka kryer pagesa për kontribute të sigurimeve shoqërore, taksa vendore dhe tatime.

- Komisioni kreu hetim në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti i bashkëshortes, duke kërkuar informacion të detajuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe

¹³ Prapësimet e subjektit depozituar në datën 24.5.2019.

¹⁴ Sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 21.5.2019.

Bashkisë Fier, për shoqërinë “****” sh.p.k., për të siguruar të dhëna të mjaftueshme për fitimin neto të deklaruar nga subjekti.

Nga Autoriteti Tatimor dhe Bashkia Fier janë paraqitur prova se “****” sh.p.k. ka kryer pagesa për kontribute të sigurimeve shoqërore, taksa vendore dhe tatime me shumat respekti vë për periudhën 2006 – 2009.

Nga hetimi i kryer për këtë aktivitet, ka rezultuar se:

- Shoqëria “****” sh.p.k. ka deklaruar qarkullim për vitet 2006, 2008 dhe 2009 në shumat 1.500.000 lekë, qarkullim mbi të cilin është llogaritur dhe paguar edhe tatim.
- Taksat vendore rezultojnë të jenë paguar vetëm për vitin 2008 dhe 2009.
- Shoqëria ka deklaruar listëpagesat e punonjësve dhe ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në shumat respektive ndër vite.
- Pagesa e qirasë mujore bazuar në deklaratën e subjektit të rivlerësimit në pyetësorin e dërguar nga Komisioni.

Komisioni, për faktin se ky aktivitet ka qenë “*kopsht privat*”, ka renditur në analizë edhe një sërë zërash për shpenzimet, pasi subjekti nuk ka dorëzuar pasqyra financiare pranë autoriteteve.

- **Në lidhje me fitimin neto të deklaruar nga aktiviteti i bashkëshortes subjektit iu kalua barra e provës.**

Subjekti, në parashtrimet e depozituara në Komision në datën 24.5.2019, ka shpjeguar se: ka shlyer detyrimet tatimore, për vitin 2007, në shumat respektive 64.500 lekë, për vitin 2007 dhe xhiro e deklaruar ka qenë 1.200.000 lekë.

Subjekti i ka mbështetur shpjegimet e tij, duke depozituar këto dokumente:

- vërtetim me nr. **** prot., datë 21.5.2019, lëshuar nga Bashkia Fier, ku provon se detyrimet përkatëse janë shlyer për këtë vit në shumën 64.500 lekë;
- akte detyrimi të vitit 2007 (pagesë me këste), me nr. **** prot., datë 2.4.2007, nr. **** prot., datë 28.2.2007, dhe një tjetër (me nr. të palexueshëm) e vitit 2007. Në bazë të këtyre akteve është bërë pagesa e detyrimeve tatimore në UBA (Banka e Bashkuar e Shqipërisë).
- Dy vërtetime nga “UBA”, ku vërtetohen pagesat e detyrimeve të kryera, nëpërmjet kësaj banke.

Bazuar në dokumentacionin për sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i ka paguar detyrimet tatimore për periudhën 2006 – 2009, për aktivitetin privat të ushtruar nga bashkëshortja.

Gjithashtu, subjekti ka depozituar një vërtetim të datës 8.11.2018, lëshuar nga ISSH-ja Fier, ku pasqyrohet se M.Ç., ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilave është derdhur kontribut për periudhën 2006 – 2009.

Sipas këtij vërtetimi situata financiare për aktivitetin privat kopshti “****”, paraqitet me gjendje pozitive.

Referuar deklarimeve të subjektit ka rezultuar se pas mbylljes së aktivitetit privat të bashkëshortes, kopshti “****” sipas deklaratës periodike vjetore në vitin 2010 subjekti ka deklaruar se nga shitja e pajisjeve dhe orendive të kopshtit të fëmijëve “****”, referuar kontratës së shitjes nr. ****, datë 17.10.2010, këto pasuri janë shitur me çmimin e shitjes prej 1.4 milionë lekë.

- **Në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga shitja e pasurive në shumën 1.400.000 lekë.**

Pas kalimit të barrës së provës subjekti i rivlerësimit paraqiti këto prova:

- Kontratë shitjeje nr. ***, datë 17.10.2010, sipas të cilës pala shitëse, znj. M.Ç., (bashkëshortja e subjektit) i shet palës blerëse në kushtet që ka mbyllur aktivitetin e saj si administratore e kopshtit “***” mjetet si: pajisje kuzhine, dollapë, tavolina, karrige, shtretër fjetje, mjete mësimore didaktike, lodra të ndryshme, tapete, etj.

- Urdhërpagese ***, tatim i mbajtur në burim, në “Intesa Sanpaolo Bank”, datë 1.6.2019, tatim për kalimin e të drejtës së pronësisë me shitje, detyrim më 19.5.2019, ku znj. Çano ka paguar detyrim tatimor në shumën 210.000 lekë, për çmimin e shitjes së pasurive në shumën 1.400.000 lekë.

Trupi gjykues, i mbledhur në datën 29.7.2019, vendosi të rihapë hetimin administrativ, për të kryer disa veprime hetimore shtese, lidhur me detyrimin tatimor për të ardhurat e realizuara nga kontrata e shitjes për pajisjet dhe orenditë e kopshtit.

Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve¹⁵ iu kërkua interpretim ligjor, nëse znj. Çano ka pasur detyrim të paguajë tatim në burim, për shumën e përfituar nga shitja e pasurive në vlerën 1.400.000 lekë, në vitin 2010, dhe nëse po, sa do të ishte vlera e përlogaritur e këtij detyrimi.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve¹⁶, ndër të tjera, informoi se në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, **do të taten fitimet që rezultojnë nga diferenca ndërmjet vlerës së shitjes së pasurive, me vlerën e blerjes së tyre.**

Në lidhje me investimet e kryera në vite për aktivitetin privat të bashkëshortes, subjekti ka shpjeguar¹⁷ se ka kryer shpenzime sipas nevojave që paraqiteshin për blerje pajisjesh, mjete e orendi të shtrira në vite, por në total për blerjen e pajisjeve dhe orendive duhet të jetë shpenzuar jo më shumë se vlera 1.400.000 lekë.

Subjekti, në prapësimet e datës 14.7.2019, ka deklaruar këto shpenzime të shtrira në vite:

Vitet	Emërtimi	Shuma në lekë
2004	Mobilim / pajisje	302.000
2005	Mobilim / pajisje	498.000
2006	Mobilim / pajisje	480.000
2007	Mobilim / pajisje	-
2008	Mobilim / pajisje	50.000
2009	Mobilin/pajisje	70.000
	Shuma totale	1.400.000

Referuar analizës financiare, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare për t'i kryer këto shpenzime.

Në lidhje me shitjen e këtyre pajisjeve, subjekti ka shpjeguar¹⁸: “*Shitja e këtyre mobilim/pajisjeve të blera në emër të shoqërisë është bërë me vlerën e mbetur e cila korrespondon me koston e blerjes pasi nga ana e subjektit nuk është llogaritur amortizimi fiskal dhe nuk është paraqitur si shpenzim në bilancet për periudhën e ushtrimit të aktivitetit.*”

¹⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.06.2019.

¹⁶ Me shkresën e datës 9.7.2019.

¹⁷ Në prapësimet e datës 14.7.2019, drejtuar Komisionit.

¹⁸ Në prapësimet e datës 14.7.2019, drejtuar komisionit.

Shitja e pasurive në vitin 2010 me vlerën e mbetur (koston) e theksojmë për efekte të mbylljes të aktivitetit, nuk ka ndikim në rezultatin financiar të subjektit sipas standardeve të kontabilitetit dhe legjislacionit fiskal, pasi me të njëjtën vlerë të mbetur regjistrohen dhe si të ardhura dhe si shpenzime në PASH (pasqyra e të ardhurave dhe të shpenzimeve) e vitit 2010, për rrjedhojë në bilanc paraqiten të netuara (zero) për efekte fiskale.

Mobilim/pajisjet e blera për vitet 2004-2005 në emër të individit M.Ç., dhe për vitet 2006 - 2010 në emër të subjektit “***” siç ju kemi vënë në dijeni janë shitur sipas kontratës nr. ***, datë 17.10.2010 nga individi M.Ç., në vlerën **1.400.000** lekë (në koston e blerjes). Në këtë periudhë subjekti tatim pagues kishte mbyllur aktivitetin dhe për rrjedhojë nuk mund të kryej shitja në emër të subjektit M.Ç., me NIPT ***. Për këto të ardhura të bashkëshortes time (në rolin e individit të deklaruar edhe në ILDKPI për vitin 2010) siç ju kemi informuar është paguar tatimi¹⁹ në burim sipas legjislacionit tatimor, pagesë për të cilën u kemi vënë në dispozicion dokumentet përkatëse”.

Trupi gjykues, nisur nga fakti që këto orendi, si raftë, dollap, mjete didaktike, etj., janë përdorur nga fëmijë, për një periudhë 3-vjeçare, konstaton se ato kanë një normë të lartë amortizimi. Me arsyetim logjik, këto pasuri si produkte të përdorura, në rastin më të mirë, nëse do shiteshin me çmimin e blerjes, fitimi do ishte zero.

- ✓ Përfundimisht, duke e konsideruar të drejtë interpretimin e autoritetit tatimor, u konkludua që subjekti nuk ka pasur detyrim për të paguar tatimin në burim.

Komisioni kreu analizën financiare për të vlerësuar aftësitë paguese të subjektit për të kryer pagesën e këstit të fundit në shumën 500,000 lekë në vitin 2011, si më poshtë:

Përshkrimi	2011
1. PASURI	7 500 000
Apartament banimi, me sip.102.6 m ² , në Tiranë	7 500 000
2. DETYRIME	7 000 000
Hua dhënë shtetasit Q.B.	7 000 000
3. PASURI NETO	500 000
4. TË ARDHURA	2 461 365
Të ardhura nga paga subjekti të dokumentuara (përfshirë të ardhurat nga Universiteti *** 2008 – 2013)	1 279 311
Të ardhura subjekti nga Universiteti ***, pagesa në “Union Bank”	291 060
Të ardhura nga paga bashkëshortja të dokumentuara	190 936
Të ardhura "Bonusi i transportit"	420 000
Të ardhura nga interesat e depozitave	280 058
5. SHPENZIME	947 122
Shpenzime jetese	409 860
Shpenzime qiraje shtëpia në Vlorë	20 000

¹⁹ Subjekti ka depozituar dokumentacion për pagesën e tatimit në burim 15 % për shumën 1.400.000 lekë, sipas urdhërpagesës nr. ***, datë 19.5.2019.

Shpenzime mobilimi për apartamentet në Tiranë	248 940
Shpenzime për transport	96 000
Shpenzime për udhëtime (TIMS)	172 322
6. LIKUIDITETE NË FILLIM	7 869 537
Depozitë bankare në “ProCredit Bank”, subjekti, në Fier	8 419
Llogari në “Credins Bank”, në lekë, subjekti	33 862
Llogari në “Credins Bank”, në lekë, bashkëshortja	7 090 564
Llogari depozite me afat në “Union Bank”, subjekti	81 566
Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, subjekti	651 742
Gjendje <i>cash</i>	3 384
7. LIKUIDITETE NË FUND	8 156 469
Depozitë bankare në “ProCredit Bank”, subjekti, në Fier	8 019
Llogari në “Credins Bank”, në lekë, subjekti	96 200
Llogari në “Credins Bank”, në lekë, bashkëshortja (nga 2010 depozita në euro e përbashkët me subjektin)	6 945 506
Llogari depozite me afat në “Union Bank”, subjekti (pagesat nga ***)	596
Llogari në euro në “Tirana Bank”, vajza	10 912
Llogari në lekë në “Tirana Bank”, vajza	1 460
Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, subjekti	387 563
Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, bashkëshortja	231
Gjendje <i>cash</i> (përgjigje të pyetësorit datë 2.11.2018)	705 983
DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 4+6-3-5-7)	727 310

- ✓ Komisioni, referuar analizës financiare, ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare për të kryer pagesën në shumën prej 500.000 lekësh, si këst i fundit për të likuiduar vlerën totale të shtëpisë.
- ✓ Nga verifikimi i të dhënave bankare, Komisioni ka evidentuar pakësimin e gjendjes së llogarive të subjektit në shumën prej 556.000 lekësh.

2. Depozitë²⁰ në “Credins Bank”, në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. M.Ç., në shumën 9.000 euro. Pjesa takuese: 50 %.

- ✓ Nga analiza financiare ka rezultuar se bashkëshortja ka pasur burime të ligjshme për të krijuar depozitën në vlerën 9.000 euro.

3. Gjendje *cash* në vlerën 600.000 lekë. Nga analiza financiare për vitin 2016 rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare për të disponuar gjendjen *cash* në shumën prej 600.000 lekësh.

²⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

Librezë depozite në emër të M.Ç., çelur në dt. 18.11.2016, në monedhën euro, me gjendje 9.000,69 euro.

Lidhur me *bonusin* e transportit të përfituar si drejtues i prokurorisë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Për vitin 2010 shpenzimi total mujor për transport ka qenë në shumën 10.000 lekë/muaj, ndërsa për vitet 2011 - 2012 shpenzimi mujor për transport deklarohet 8.000 lekë/muaj, shoqëruar edhe me një deklaratë para noterit të kolegut, z. A.Xh., i cili pranon se ka ndarë shpenzimet e transportit me subjektin dhe kolegë të tjerë të punës”.

Trupi gjykues analizoi deklaratën noteriale të kolegut me të cilin subjekti ka ndarë shpenzimet e transportit për të shkuar në punë dhe deklaratimet e subjektit, si dhe mbështetur në faktin që ky *bonus* është i pakthyeshem, ka çmuar të marrë në konsideratë këto kursime, duke i reflektuar në analizë financiare.

➤ **Pasuria e deklaruar nga personi i lidhur me subjektin, e bija A.Ç.**

4. Apartament²¹, me sip. 63 m², vlera 53.000 euro, blerë në vitin 2014, me adresë: Rr. “****”, nd. ***, h. ***, ap. ***. Kjo pasuri është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë sipas kontratës së shitblerjes datë 11.7.2014. Si burim krijimi, e bija e subjektit ka deklaruar: kursimet e prindërve. Pjesa takuese: 100%.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

ZVRPP-ja Tiranë²², ka konfirmuar se znj. A.Ç., ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, pasurisë apartament me sip. 63 m², nr. ***, z.k. ***, vol. *** f. ***.

OSHEE-ja²³ ka informuar se në emër të znj. A.Ç., identifikohet kontrata ***, me status aktiv, në adresën: Rr. “****”, nr. ***, pll. ***, shk. ***, me datë hapje 10.2.1998.

UKT-ja²⁴ ka informuar se znj. A.Ç., është abonente me kontratë me nr. ***, me adresë: Rr. “****”, me status aktiv.

✓ Komisioni vëren se deklarimi i personit të lidhur përputhet me dokumentacionin e administruar në dosje.

➤ **Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar burimet e ligjshme për blerjen e këtij apartamenti**

Përshkrimi	2014
	7 425 830
Apartament i blerë nga vajza e subjektit me sip. 63 m ² , Rr." **** ", Tiranë	7 425 830
2. DETYRIME	0
3. PASURI NETO	7 425 830
4. TË ARDHURA	2 136 764
Të ardhura nga paga subjekti të dokumentuara (përfshirë të ardhurat nga Universiteti *** 2008 - 2013)	1 285 864
Të ardhura nga paga bashkëshortja të dokumentuara	603 802

²¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, apartament me sip. 63.00 m², me numër pasurie ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, në emër të A.Ç. Bashkëlidhur kartelë pasurie.

Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme, nr. ***, datë 11.7.2014. Palë blerëse A.Ç., dhe palë shitëse A.S., (Sh.), E.L. (Sh.), A.I. (Sh.), M.Sh. Vlera e pasurisë 53.000 euro. Bashkëlidhur praktika përkatëse. Faturë transfertë “Credins Bank” e shumës 53.000 euro në datën 11.7.2014.

²² Shkresa nr. *** prot., datë 19.9.2018, drejtuar ZQRPP-së.

²³ Shkresa nr. *** prot., datë 19.9.2018, drejtuar OSHEE-së.

²⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 19.9.2018, drejtuar UKT-së.

Të ardhura nga paga e vajzës, A.Ç.	107 098
Të ardhura nga dhënia me qira e apartamentit të vajzës së subjektit A. Ç.	140 000
5. SHPENZIME	686 360
Shpenzime jetese	661 140
Shpenzime për udhëtime (TIMS)	25 220
6. LIKUIDITETE NE FILLIM	8 721 029
Depozitë bankare në “ProCredit Bank”, subjekti, në Fier	4 869
Llogari në “Credins Bank”, në lekë, bashkëshortja	8 266 695
Llogari depozite me afat në “Union Bank”, subjekti	15 253
Llogari rrjedhëse në Raiffeisen Bank subjekti	246 425
Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, bashkëshortja e subjektit	3 192
Gjendje <i>cash</i>	184 595
7. LIKUIDITETE NE FUND	1 360 550
Depozitë bankare në “ProCredit Bank”, subjekti, në Fier	3 069
Llogari në “Credins Bank”, në lekë bashkëshortja (nga 2010 depozita në euro e përbashkët me subjekti)	980 867
Llogari depozite me afat në “Union Bank”, subjekti (llogari paga, U. ***)	15 391
Depozitë bankare në “UBA”, vajza e subjektit	200 000
Gjendja e llogarisë rrjedhëse të vajzës së subjektit në “BKT”	10 122
Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, subjekti	145 127
Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, bashkëshortja e subjektit	5 975
Gjendje <i>cash</i> (përgjigje të pyetësorit, datë 2.11.2018)	0
DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 4+6-3-5-7)	1 385 053

Nga verifikimi i likuiditeteve të subjektit në bankë ka rezultuar se shuma 53.000 euro është transferuar nga llogaria e znj. M.Ç., te llogaria e znj. A.Ç., dhe nga llogaria e kësaj të fundit kjo shumë është transferuar brenda ditës në datën 11.7.2014 në llogarinë e noteres I.Sh., me përshkrimin përkatës.

Komisioni, nga analiza financiare e kryer sipas tabelës sa më sipër, ka konstatuar se:

- ✓ Subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme për të blerë apartamentin në vitin 2014.
- ✓ Nga verifikimi i likuiditeteve bankare provohet se shuma 53.000 euro është transferuar nëpërmjet llogarisë së noteres, tek e bija e subjektit.

KONKLuzion Përfundimtar Mbi Pasurinë

Për sa më sipër nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit vërehet se nuk janë konstatuar elemente, të cilat mund të ngrenë dyshime për fshehje apo deklaram të rremë nga subjekti i rivlerësimit. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të mjaftueshme. Pas verifikimit deklarimet e subjektit rezultojnë të sakta dhe në përputhje me ligjin. Subjekti ka burime të ligjshme për krijimin e tyre.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Mbledhja e informacioneve dhe provave mbi pastërtinë e figurës

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar raportin, me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së, nr. ***, datë 27.9.2018), për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar: *“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çano”*.

Sipas këtij raporti subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

- ✓ **Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çano ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.**

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit është bërë nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme²⁵ i cili ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar. Raporti është bazuar në të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Raporti i Prokurorisë së Përgjithshme është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) formularit të vetëdeklarimit, të tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 2) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) të dhënave nga burimet arkivore të prokurorisë/ve

GJETJET NGA FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA VETË SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

- a) saktësia e formularit të vetëdeklarimit;
- b) formulari paraqitet i plotë, i nënshkruar, pa mangësi dhe pa kundërthënie, sipas shtojcës që parashikon ligji. Nuk rezulton të ketë mangësi nga pikëpamja formale. Subjekti ka deklaruar të dhënat duke iu referuar periudhës së rivlerësimit 1.1.2014 - 31.12.2016;
- c) përvoja profesionale në 10 vitet e fundit; dhe

Sipas të dhënave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, për periudhën:

²⁵ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73 -76, të ligjit nr. 96/2016.

- dhjetor 2016 e në vazhdim, ushtron funksionet e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë;
- shkurt 2013 deri në dhjetor 2016 ka punuar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë;
- prill 2008 deri në janar 2013 ka punuar drejtues prokurorie në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Lushnjë;
- janar 2008 deri në mars 2008 ka punuar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë; dhe
- janar 2006 deri në janar 2008, ka punuar drejtues prokurorie në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Vlorë.

d) detyrat e kryera tre vitet e fundit dhe të dhënat statistikore.

Referuar dosjes së burimeve njerëzore dhe formularit të plotësuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çano, si dhe të dhënave statistikore të administruara për procesin e shortimit të pesë dokumenteve në mënyrë rastësore sipas procesverbalit të datës 12.11.2018, rezulton se për periudhën 8.10.2013 – 8.10.2016, ka të dhëna statistikore si më poshtë vijon:

Referuar formularit të plotësuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çano, rezulton se nga shkurti i vitit 2013 deri në dhjetor të vitit 2016 ka ushtruar funksionet e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë. Gjatë tre viteve të fundit të ushtrimit të detyrës subjektivit të rivlerësimit, z. Petrit Çano, i janë caktuar gjithsej 626 (gjashtëqind e njëzet e gjashtë) çështje dhe 265 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) materiale kallëzuese nga të cilat ka përfunduar 587 (pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) çështje dhe 265 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) materiale kallëzuese.

Referuar procesverbalit “Për pasqyrimin e veprimeve të përzgjedhjes së pesë dosjeve për subjektin e rivlerësimit”, datë 12.11.2018, rezulton se z. Petrit Çano ka trajtuar gjithsej 644 (gjashtëqind e dyzet e katër) çështje, nga të cilat 14 (katërbëdhjetë) janë akte të prokurorit si drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë; 158 (njëqind e pesëdhjetë e tetë) janë çështje të pezulluara; 223 (dyqind e njëzet e tre) janë çështje për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal; 78 (shtatëdhjetë e tetë) janë çështje për të cilat është marrë vendim pushimi; 168 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë) janë çështje të dërguara për gjykim.

TË DHENAT ARKIVORE (ankesat dhe masat disiplinore)

Referuar të dhënave arkivore pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme për prokurorin subjekt rivlerësimi, z. Petrit Çano, rezulton se ndaj këtij subjekti nuk ka masa disiplinore.

Nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se ndaj subjektivit të rivlerësimit, z. Petrit Çano, janë paraqitur këto ankesa:

1. Në datën 27.3.2006 në Prokurorinë e Përgjithshme është paraqitur një ankesë nga shtetasi Gj.H., ndaj drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, z. Petrit Çano, dhe prokurores V.H., duke pretenduar se kanë vendosur arbitrarisht në lidhje me procedimin penal në ngarkim të djalit të tij. Kjo ankesë i është bërë prezent prokurorit të Rrethit Vlorë duke e porositur që të sqaroj ankuesin. Nuk ka të dhëna të tjera se si është vepruar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

2. Në datën 11.1.2013 në Prokurorinë e Përgjithshme është paraqitur një ankesë nga shtetasja A.V., e cila pretendon se drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, z. Petrit Çano, i ka marrë shumën e 30.000 (tridhjetë mijë) euro për uljen e dënimit të

bashkëshortit t saj, G.V., dhe më pas një shumë tjetër prej 6.000 (gjashtë mijë) euro për mosankimim të vendimit të gjykatës. Nga Prokuroria e Përgjithshme është bërë verifikimi i rastit dhe në përfundim është konkluduar se ka disa shkelje nga Prokuroria e Rrethit Lushnjë, për të cilat është tërhequr edhe vërejtje, por ndodhur në kushtet kur ky procedim penal është dërguar për gjykim, është gjykuar, dhe vendimi i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka marrë formë të prerë, ankueses i është bërë më dije se vendimet e formës së prerë janë tituj ekzekutiv dhe nuk mund të cenohen.

Nga Komisioni iu kërkua Prokurorisë së Përgjithshme të dhëna në lidhje me këtë ankesë, si dhe në lidhje me denoncuesen A.V., në mënyrë që të thirrej, për të dhënë shpjegimet e saj për këtë rast, në Komision.

Prokuroria e Përgjithshme²⁶ ka depozituar dosjen e plotë të verifikimit që i është bërë kësaj ankese, si dhe shkresën e kësaj ankese. Adresa rezulton të jetë e pa plotë.

Komisioni kreu një hetim të këtij rasti, duke u përpjekur të verifikojë vërtetësinë e këtij denoncimi dhe tentoi që të thërrasë shtetasen A.V., për të dëshmuar për denoncimin e depozituar. Nga hetimi i kryer nga Komisioni rezultoi:

- a) Nga verifikimi që iu bë shtetasës A.V., si nga regjistri i gjendjes civile, ashtu dhe në sistemin *TIMS*, rezulton se nuk ekziston një shtetase me këto të dhëna.
- b) U verifikua identiteti i b/shortes së ish të dënuarit G.V., e cila nuk përkonte me identitetin e denoncueses. Bashkëshortja e denoncuesit nuk njihte asnjë person me identitetin A.V.
- c) Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. *** prot., datë 13.3.2019, drejtuar ONM-së, është shprehur se nuk ka ndonjë dokument apo akt që të tregojë se është “*këshilluar*” apo “*qortuar*” prokurori i çështjes apo drejtuesi i prokurorisë, për rastin “***”.

Përfundimisht, nga hetimi i kryer, u konkludua se nuk u provuan shkeljet e pretenduara.

3. Me shkresën me nr. *** prot., datë 22.2.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat bën me dije se për subjektin Petrit Çano është regjistruar materiali kallëzues me nr. ***, datë 12.6.2017, i referuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, që bën fjalë për kallëzimin e shtetasit M.T., ndaj shtetasve A.D., S.M., Petrit Çano, A.H., R.Z., dhe Ç.Sh., dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat është vendosur mosfillimi i procedimit penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Gjithashtu, nga të dhënat e administruara nuk rezulton që ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çano, të jetë regjistruar tjetër kallëzim penal ose procedim penal. Nuk ka të dhëna apo informacione për cenim të figurës së subjektit të rivlerësimit në të cilat të jetë përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, si dhe të dhëna për raste të identifikimit të subjektit të rivlerësimit për kontakte me persona të papërshtatshëm.

Për vitet 2014, 2015 dhe 2016 - subjekti Petrit Çano është vlerësuar “*shumë mirë*” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, pasi detyrat e ngarkuara i ka kryer me cilësi dhe shpejtësi.

ANALIZA E GJETJEVE²⁷

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënave nga burimet arkivore në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

²⁶ Me shkresën nr. *** rep., datë 5.3.2019.

²⁷ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73 – 76 të ligjit nr. 96/2016.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga gjetjet në grupet e burimeve të informacionit për periudhën e vlerësimit 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, rezultojnë se:

Nga vlerësimet e punës së subjektit Petrit Çano për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezultojnë se ai është vlerësuar “shumë mirë”, për aftësitë profesionale të tij, si në hetimet dhe gjykimet që ka ndjekur personalisht, ashtu dhe në menaxhimin e drejtë dhe në kohë të arsyeshme të shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të çështjeve që ka patur në ndjekje.

Subjekti i rivlerësimit prokurori Petrit Çano shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon drejtë normën ligjore të zbatueshme dhe argumenton arsyet zbatimin e saj në rastin konkret.

Në lidhje me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi analizës së elementëve të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin ligjor të faktit penal.

Subjekti i rivlerësimit, Petrit Çano, shfaqë aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e provave dhe arsyetimin ligjor e logjik, duke marrë e përpiluar vendime e akte të kuptueshme, me tekst të qartë.

Nga dokumentet e dorëzuara nga vetë subjekti i rivlerësimit, rezultojnë se merr pjesë në aktivitete të profesionale për ngritjen e nivelit të tij profesional, si dhe në shkëmbimin e eksperiencave si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

b) Arsyetimi ligjor

Bazuar në tre aktet e dorëzuara dhe në pesë dosjet e shortuara për subjektin Petrit Çano, konstatohet se subjekti shfaqë aftësi në arsyetimin ligjor të akteve. Këtë e tregon mënyra e qartë e pasqyrimin të rrethanave të faktit, analiza e provave dhe ballafaqimi i tyre me bazën ligjore të aplikueshme, si dhe përpilimi i kërkimeve të prezantuara në këto akte në mënyrë të saktë dhe të duhur, sipas kërkesave të ligjit. Vendimmarrja e prokurorit, subjekt vlerësimi, e pasqyruar në pjesën arsyetuese është e qartë dhe e kuptueshme, ku evidentohet referimi në bazë ligjore. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimmarrjes.

Struktura e akteve është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori, ku konstatohet se në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore.

2. Aftësitë organizative

Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çano, për periudhën e rivlerësimit përreth dhjetë muaj ka qenë në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë siç është përmendur edhe më lart në këtë raport dhe për këtë arsye është spikatur dhe është vlerësuar për aftësi shumë të mira drejtuese. Më konkretisht ka rregulluar organizimin dhe mirëfunksionimin e punës së çdo strukture nëpërmjet urdhrave të detajuar, duke mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm ecurinë efektive të hetimeve dhe punën e secilit prokuror. Gjithashtu, ka drejtuar punën për vlerësimin e punës së prokurorëve, sipas parashikimeve të rregullores përkatëse. Ka bërë planifikim të saktë të ndarjes së punës te prokurorët e stafit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti Petrit Çano ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, ka kryer hetime, ka drejtuar dhe kontrolluar veprimtarinë hetimore brenda një afati të arsyeshëm, në raport me kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e çështjeve, ndërkohë që këto fakte janë prezantuar dhe në vlerësimin përgjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, vlerësim i cili për këto vite ka qenë “*shumë mirë*”.

Referuar procesverbalit “Për pasqyrimin e veprimeve të përzgjedhjes së pesë dosjeve për subjektin e rivlerësimit”, datë 12.11.2018, rezulton se z. Petrit Çano ka trajtuar gjithsej 644 (*gjashtëqind e dyzet e katër*) çështje, ku 14 (*katërmëdhjetë*) janë akte të prokurorit si Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë; 158 (*njëqind e pesëdhjetë e tetë*) janë çështje të pezulluara; 223 (*dyqind e njëzet e tre*) janë çështje për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal; 78 (*shtatëdhjetë e tetë*) janë çështje për të cilat është marrë vendim pushimi; 168 (*njëqind e gjashtëdhjetë e tetë*) janë çështje të dërguara për gjykim.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Prokurori subjekt rivlerësimi, z. Petrit Çano, rezulton se ka kryer veprimet e duhura hetimore në kohë të arsyeshme. Nga subjekti është realizuar mbledhja në kohë e provave dhe burimeve të provave të domosdoshme, të cilat janë vënë në bazë të akuzave të ngritura, të cilat janë dërguar për gjykim. Për sa i takon vendimmarrjes subjekti është kujdesur në njoftimin e subjekteve dhe palëve të interesuara, duke u bërë të ditur edhe të drejtën e ankimit, e faktuar kjo me shkresat përkatëse, ose me nënshkrimin e tyre në aktet përkatëse, cilësi këto të pasqyruara dhe në vlerësimet e bërë nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ku është vlerësuar “*shumë mirë*”.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Prokurori Petrit Çano ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve, të rregullsisë së akteve dhe të mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të sakta, të strukturuara në respektim të normave të drejtshkrimit.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë nga prokurori Petrit Çano rezulton se janë përmbushur me korrektësi kërkesat për disiplinën e punës dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit. Nga aktet e dosjeve të shqyrtuara për efekt të procesit të rivlerësimit konstatohet nivel i pëlqyeshëm përgjegjshmërie në administrimin e duhur të akteve ligjore nga subjekti i rivlerësimit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit prokurori Petrit Çano dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Në lidhje me vlerësimin e paanësisë për subjektin të rivlerësimit, z. Petrit Çano, për periudhën objekt vlerësimi nuk rezulton të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe të papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar, apo të jenë diskutuar cenim të të drejtave të pjesëmarrësve në proces, apo të grupeve shoqërore vulnerable. Në asnjë prej pesë

dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Në tre dokumentet ligjore, si dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çano, në periudhën e vlerësimit ka shfaqur aftësi komunikuese të mira. Bashkëpunimi, sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratën, ka qenë korrekte duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre.

Ka cilësi të mira bashkëpunuese, tregohet i gatshëm të punojë në grup, dhe me agjenci të tjera ligjzbatuese, është i hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët. Ka shfaqur aftësi dhe këmbëngulje në organizimin me efektivitet të burimeve materiale dhe njerëzore të prokurorisë, duke i menaxhuar me përsosmëri këto burime.

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, për periudhën objekt vlerësimi subjekti Petrit Çano rezultoi të jetë angazhuar në një sërë aktivitete profesionale të organizuara, qoftë në rolin e pjesëmarrësit, qoftë si lektor.

➤ Ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar nga publiku dhjetë denoncime.

Me shkresat me nr. *** prot., datë 23.01.2018, dhe nr. *** prot., datë 11.03.2019, nga shtetasia L.B., janë të depozituar dy denoncime për subjektin.

Denoncuesi L. B., pretendon se makina e tij e ndodhur e parkuar poshtë pallatit ku banon është përplasur nga një automjet. Pas interesimit të tij në zonën ku e kishte parkuar automjetin rezultoi se ishte përplasur nga shtetasja A.Ç., e bija e subjektit të rivlerësimit. Subjekti informon se ka bërë dhe denoncim në polici. Më pas informon se ka kontaktuar me z. Çano nëpërmjet *facebook* për ta zgjidhur çështjen në mënyrë miqësore për dëmshpërblimin që pretendonte. Denoncuesi deklaroi se është takuar me z. Petrit Çano poshtë pallatit ku banojnë pasi janë fqinj, por nuk kanë arritur në një marrëveshje në lidhje me dëmin e shkaktuar. Denoncuesi shpjegoi se subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çano, kishte propozuar inskenimin e një aksidenti për të përfituar dëmshpërblim nga siguracioni. Denoncuesi pretendon se e vijoi këtë çështje në prokurorinë e Tiranës. Prokurori i çështjes e ka çuar rastin në gjykatë dhe ka kërkuar pushimin e çështjes. Sipas denoncuesit gjyqtari që e ka shqyrtuar çështjen është shprehur se për dëmin e shkaktuar nuk ka kush të paguajë shpërblimin sepse nuk ka emër të personit që ka shkaktuar dëmin, dhe se emri i znj. A.Ç., nuk figuronte gjëkund. Denoncuesi ka pretenduar që subjekti i rivlerësimit ka ndikuar tek prokurorët për të deformuar realitetin mbi përplasjen e makinës së denoncuesit nga vajza e tij.

Në lidhje me këtë denoncim, trupi gjykues, për të verifikuar dhe konfirmuar deklaratimet e denoncuesit, duke i vlerësuar ato si të rëndësishme, thirri në cilësinë e dëshmitarëve:

- denoncuesin L.B, për të treguar rrethanat e ngjarjes;
- administratorin e pallatit ku banon subjekti;
- vajzën e subjektit znj. A.Ç.;
- gruan që administron parkingun F.L., e cila pas 2 njoftimesh nuk u paraqiti; dhe
- pronarin Q.D., i një automjeti të bardhë përdorur në një udhëtim nga subjekti.

Komisioni, pas hetimit të kryer dhe marrjes së dëshmive, vlerëson se nuk ka indice konkrete të shkeljeve të kryera nga subjekti dhe se kjo çështje nuk lidhet me subjektin por me familjarë të tij.

Në përfundim, trupi gjykues pasi verifikoi çështjen, faktet, deklaratimet dhe provat e administruara, konkludoi se nuk u provuan pretendimet e ngritura nga denoncuesi, për subjektin e rivlerësimit.

Denoncime të tjera për subjektin e rivlerësimit

Denoncimi me nr. *** prot., datë 6.4.2018, i shtetas D.D.
Denoncim me nr. *** prot., datë 5.10.2018, i shtetasit Xh.Xh.
Denoncim nr. *** prot., datë 20.3.2018, i shtetasit G.T.
Denoncim me nr. *** prot., datë 29.12.2017, i shtetasit A.Rr.
Denoncim me nr. *** prot., datë 29.12.2017, i shtetasit A.Rr.
Denoncim nr. *** prot., datë 13.2.2019, i shtetasit Sh.M.
Denoncim me nr. *** prot., datë 9.1.2019, i “ Raiffeisen Bank”.
Denoncim ardhur me postë elektronike në datën 18.6.2019, i shtetasit P.L.

Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet e sipërpërmendura dhe pasi kreu verifikimet përkatëse, konstaton se ato nuk përmbajnë fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, nga verifikimi i denoncimeve nuk u konstatuan indice për veprime korruptive apo kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Me cilësinë e relatores së çështjes, pas shqyrtimit të Raportit të hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme, dhe pas hetimit të pavarur të Komisionit, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Nuk u provua asnjë indice apo element që çënon figurën e prokurorit Petrit Çano, sipas parashikimeve në nenin 44/a, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit propozoj: **“I aftë”**.

V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Petrit Çano, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Petrit Çano, me funksion prokuror/drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkalës së Parë Krujë.

2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 19.7.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Suela ZHEGU
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha

P/Gledis Hajdini